



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 3

Rrogozhinë, më 27.03.2023 ora 14 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.1191.Prot datë 21.03.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.02.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i Relacionit “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 02.03.2000 për emrin e shkollës 9- vjeçare ‘Xhorxh Soros’ “.
- 6- Miratim i projekt-vendimit , “Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë Fshat, parcela 35/4, 35/5, 35/13 ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për disa ndryshime në VKB-në Nr.6, datë 27.01.2020 ‘Për Krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira) “.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin subvencionimi i interesave të kredisë”.
- 9- Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.
- 10- Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i listës së aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2023.
- 11- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
- 12- Të ndryshme.



- *Shqyrtim të thirrjes së kontabilistit të shoqërisë “Klub Futboll Egnatia” Sha, drejtuar aksionerëve të kësaj shoqërie.*
- *Shqyrtim të kërkesës për ndihmë të menjëhershme ekonomike për një familje banuese në fshatin Zhabjak, propozuar nga Administratori i Njësisë Administrative Kryevidh z. Shkelqim Gjoni.*
- *Shqyrtim i kërkesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për prerjen e disa pishave përgjatë kësaj lagjeje që mbartin pluhur dhe janë kthyer në problem për shëndetin e banorëve.*
- *Shqyrtim i ankesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për rregullimin e lagjes ku jetojnë shtrimin, kullimin, ndriçimin e saj.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Emiliano Aliu, Petrit Haska, Reshit Kala, Enver Memolla, Sheqere Biba, Fatmira Thartori, Mejte Saliu, Alime Hoxha, LulzimHasa, Alban Sula, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Margarita Dedej, Erind Tosku, Anjeza Proshka, Haqim Tosku, Anvi Kasa, Agim Pepa, Vojsava Pipa, Luan Sheshi, Fatjon Biba.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Andi Proshka - Drejtor i Bujqësisë, Pyjeve, Veterinarisë, Kullimit dhe Vadijtes.
4. Geraldo Gjini - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Helidon Plaku - Drejtor i zyrës Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun.
6. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
7. Fatmir Meçaj - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sportit.
8. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
9. Artur Kaja - Përgjegjës i Pyjeve.
10. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
11. Harun Murrani - Specialist i Administrimit Vendor dhe Strehimit.
12. Dorina Maçolli - Koordinatorë e dhunës në familje.
13. Endrin Ajdini - Punonjës i sektorit të Kulturës.



14. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 11 Këshilltarë.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : z. Emiliano Aliu, z. Petrit Haska, z. Reshit Kala, z. Enver Memolla, znj. Sheqere Biba, znj. Fatmira Thartori, znj. Mejte Saliu, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, z. Alban Sula dhe Mukades Gixhari. Gjithsej jemi 11 Këshilltarë.

Kalojmë në leximin e “Verifikimit Ligjor” ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për vendimet e Këshillit Bashkiak të datës 27.02.2023. Lexon nënkryetari z. Emiliano Aliu. Emiliano fjala për ju.

Emiliano Aliu . Faleminderit, atëherë “Verifikim ligjshmërie” ardhur në datën 15 Mars 2023, Nr.368/1.Prot nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 gërma a, neni 16, gërma 2/a dhe Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr.3,4,5,6,7 datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Vendimi nr.3, datë 27.02.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “ është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr.4, datë 27.02.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor” është në përputhje me ligjin.

Vendimi nr.5, datë 27.02.2023 “Për miratimin e planit të emergjencave civile 2023 dhe dokumentin për vlerësimin dhe menaxhimin” është në përputhje me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.



Vendimi nr.6, datë 27.02.2023 “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit të rrugës sipër hekurudhës faza e I-rë” nuk është në përputhje me ligjin nr.139/2015.

Vendimi nr.7, datë 27.02.2023 “Për miratimin e fondit për projektin “Tungjatjeta Jetë” shërbim lëvizës për fëmijë me aftësi të kufizuar” është në përputhje me ligjin nr.139/2015.

Mukades Gixhari . Faleminderit Emiliano! Tani përpara se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës do të gjeni të fotokopjuar përpara kopje të dëgjësës publike dhe marrje mendimi në fshatin Zhabjak Zeshtik Njësia Administrative Kryevindh dhe një kërkesë të komitetit të veteranëve të LANC-it dhe pasardhësit e nderit të kombit Bashkia Rrogozhinë. Jeni dakord t’i përfshijmë në rendin e ditës? Dhe vota ime shkon pro miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro përfshirja në rendin e ditës për shqyrtim të kopjes së dëgjësës publike për varrezën e fshatit Zhabjak, Zeshtik dhe kërkesa e komitetit të veteranëve të LANC-it.

Mukades Gixhari . Fillojmë . Miratimi i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e dytë, Miratimi i procesverbalit nr.2, të mbledhjes së këshillit bashkiak datë 27.02.2023. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratimi i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i bllok – ndihmës 6%. Përgjegjësi i Shërbimit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Përshëndetje! Atëherë janë në total 21 familje me fond 36 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë? Po z. Enver.

Enver Memolla . Është bërë e disata herë që kjo pjesa e ndihmës ekonomike për 6% dhe 3% bëhet problem dhe shpërndahet me vonesë. Fakt i kryer është muaji Janar bashkë e dimë çfarë ndodh në Janar dhe kur është marrë Janari. Tani jemi në fund Marsi, pyetja lind Shkurti kur merret, pyetja është dhe për drejtorin e financës dhe për ty.



Ledian Hasani . Atëherë Shkurti është në moment që do ta miratojë Prefektura pastaj vepron financa.

Rezart Vogli . Duke qenë se projektvendimi i kaluar është miratuar me vonesë nga ana e Prefekturës, Emiliano lexoje pak, vendimet e mbledhjes së kaluar kur janë miratuar nga Prefektura.

Emiliano Aliu . Atëherë 15.03.2023 e lexova që në fillim fare.

Enver Memolla . Atëherë mesa kuptova pyetja ishte e qartë Shkurti kur do merret i bie që brenda 10 ditëve kjo duhet të miratohet nga Prefektura dhe brenda javës tjetër do ta kryej, se pse po shoh një mosrakordim midis zyrës së financës dhe zyrës së Shërbimit Social në Bashkinë Rrogozhinë se ku çedon unë këtë pjesë nuk e di. Por realisht e kam thënë shumë herë si nga Kryevidhi, Sinaballaj, Lekaj, Rrogozhinë dhe Gosë është gjynah të sorollaten njerëzit për 18 mijë lekë të vjetra. Shkoj tek zyra e ndihmës ekonomike e kemi çuar atje, hajde tek posta ku e ka çuar më shumë e kam tek njerëzit që janë përfitues. Se realisht ta miratosh sot që jemi 27 dhe të vijë në 27 Prill, ky është problemi që e kanë banorët jo unë.

Ledian Hasani . E kemi të gjithë si problem jo vetëm banorët edhe ne që jemi në zyra e kemi problem.

Enver Memolla . Pikërisht se ne punojmë kur shpërndahet unë të marr në tel direkt të vë në dijeni. Ideja është ping pongu që i bëhet popullatës, është gjynah 1800 lekë apo 3300 lekë sa mund të shkojë shuma maksimale është gjynah të vijë poshtë e lart. Është diçka e patolerueshme nga ana njerëzore pastaj pjesa ligjore është pjesë tjetër se mund të vonohet dhe realisht punonjësit të jenë të paktën ja kemi çuar financës nuk ka ardhur akoma nga prefektura, të jepet përgjigja e duhur. Kaq kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver. Ndonjë pyetje tjetër? E hedhim në votim. Pro? Kundër? Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 11 vota pro pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

Vendim nr.8. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.942.Prot datë 10.03.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, Miratim i projektvendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor. Vazhdojmë po me përgjegjësin e shërbimit social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë janë 19 familje që janë përfituese dhe fondi është 79 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim, pyetje? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr .9. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1107.Prot datë 20.03.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5 (pesë), miratim i projektvendimit “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 02.03.2000 për emrin e shkollës 9- vjeçare ‘Xhorxh Soros’ “. Këtë do na e relatojë Përgjegjësi i zyrës së arsimit të Bashkisë z. Arben Daja. Përshëndetje z. Arben! Mund të afrohesh.

Arben Daja . Përshëndetje! Relacion për një ndryshim të vendimit Nr.15, datë 02.03.2000 të Këshillit Bashkiak për emërtimin e shkollës “Xhorxh Soros”. Duke qenë se personalitete të tilla si Xhorxh Soros Kryetari i Bordit financues të shkollës 9-vjeçare në Rrogozhinë është një personalitet i njohur në gjithë botën për aktivitetet e tij në fushën kulturore dhe humanitare, si dhe fakti që anglishtja është gjuhë e ndërkombëtarizuar e njohur gjërësisht në të gjithë botën. Po ashtu me një vend të rëndësishëm në kurrikulat tona shkollore propozojmë që emri i shkollës “Xhorxh Soros” të shkruhet i njëjtë si në gjuhën angleze “George Soros” për arsye të mosdeformimit të emërimit si dhe njohjes apo përdorimit të gjërë të emrit të këtij personaliteti në interes të medias ndërkombëtare të shkrimeve biografike apo autobiografike për personalitetin në fjalë, ku emërtimi i shkollës mund të përdoret si element referues.

Vëmë në dukje faktin që nëse ky emër do të shkruhej në gjuhën tonë, ai nuk është i njohur për elementin ndërkombëtar, pa diskutuar më pas edhe faktin që emrat që vijnë nga anglishtja kanë specifikat e tyre në lexim. Duke qenë se Xhorxh Soros është edhe qytetar nderi i Bashkisë Rrogozhinë, e mendojmë të arsyeshme nderimin dhe vlerësimin e tij edhe nëpërmjet drejtshkrimit të saktë emrit të tij në gjuhën angleze. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Arben. Ndonjë pyetje diskutim në lidhje me emrin e shkollës “Xhorxh Soros”? E hedhim në votim. Pro? Kundër? Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 11 vota pro pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr .10. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë me shkesë Nr.965.Prot datë 13.03.2023, “Relacion për një ndryshim të Vendimit Nr.15, datë 02.03.2000 të Këshillit Bashkiak për emrin e shkollës 9-vjeçare ‘Xhorxh Soros’ “.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6-të, Miratim i projekt-vendimit , “Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë Fshat, parcela 35/4, 35/5, 35/13 ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë”. Do na relatojë drejtori i Bujqësisë z. Andi Proshka. Përshëndetje z. Andi, fjala për ju!

Andi Proshka . Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë Fshat, parcela 35/4, 35/5, 35/13 ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 265 dhe neni 277 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”Drejtoria e Bujqësisë, Sektori i Bujqësisë në Bashkinë Rrogozhinë nisur nga kërkesa e bërë nga disa banorë të zonës me nr.1453. prot datë 12.04.2022 për hapje rruge kalimi nga pronat e tyre deri tek rruga kryesore, evidentoi sipërfaqen e tokës bujqësore për tu përdorur si rrugë kalimi, e cila ka një gjatësi prej 950 ml dhe gjërësi 4 m për këtë qëllim Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Rrogozhinë propozon: Miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe toke bujqësore e cila ka shërbyer si rrugë kalimi por që me kalimin e kohës është ngushtuar dhe ka nevojë për zgjerim. Kjo sipërfaqe ndodhet në lagjen e “Shimëve” Rrogozhinë Fshat dhe përfshin parcelat nr.272/1 dhe 274/1, ZK 3235 dhe në Sinaballaj parcelat 35/, 35/5 ZK 3450. Bashkia Rrogozhinë mbështetet në aktet ligjore e nënligjore të dala për këtë qëllim. Relacioni : Hapja e kësaj rruge do të shërbejë për : Kalimin e lirë të njerëzve dhe mjeteve për në pronat e banorëve të zonës. Duke qenë se pjesa më e madhe e gjurmës së rrugës është ekzistuese nga ana jonë do të bëhet zgjerimi i saj në disa pjesë të saj dhe riparimi i një pjese në vendin ku bashkohet parcela 35 me parcelat 272/1 dhe 274/1. Gjithashtu kjo rrugë do të shërbejë për hyrjen e zjarrfikëseve në rast të rënies së zjarrit në këto sipërfaqe. Parcela që do të shërbejë si servitut kalimi është e pasqyruar në tabelën e mëposhtëme.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim, pyetje.

Emiliano Aliu . Deri sa është servitut kalimi që përdoret për kalimin e mjeteve bujqësore dhe për motive të tjera... Veri.

Enver Memolla . Andi faleminderit ty! Realisht po shikoja kërkesën e banorëve në 12 Prill ... faktikisht kjo procedurë që ka ndjekur Bashkia ... për mendimin tim unë kam qenë relator i



këtyre banorëve në Këshill kjo duhet të bëhet dhe për pjesën tjetër të banorëve. Se realisht dhe për ato bujq është nder i madh për ato, realisht është nder nga ana e Këshillit lokal sepse po kapim verën e 2023 dhe realisht ishte gjynah që ke tokë kam por nuk kam ku kaloj. Realisht shyqyr që shkresa gjeti derën e them pa dorashka dhe shumë faleminderit për punën që ke bërë atje kjo vjen jo nga unë por nga banorët e zonës që janë atje. Kjo të jetë nisma për të gjithë Bashkinë aq sa janë mundësitë por kjo të jetë nismë për të gjithë Bashkinë se realisht këto janë ato punë që duhen. Faleminderit.

Mukades Gixhari . Faleminderit Veri. Ndonjë diskutim tjetër?

Alime Hoxha . Është bërë gjurma, është hapur rruga? Ka probleme?

Enver Memolla . Është bërë gjurma, nuk ka probleme edhe banorët kanë qenë aty.

Andi Proshka . Ne i kemi çuar të gjithë në Bashki kemi rënë dakord ...

Enver Memolla . Është bërë dhe dëgjesa publike.

Alime Hoxha . A ka pronarë toke që preken këtu e kisha?

Andi Proshka . Jo kanë qenë vetë...

Enver Memolla . Kanë shkukur ullinj të vetëm të dali të kalojë, ishte për fishekzjarre.

Mukades Gixhari . Ndonjë gjë tjetër? E hedhim në votim. Pro? Kundër? Abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

- *Miratohet me 11-vota pro pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.*

Vendim nr .11. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1263.Prot datë 27.03.2023, “Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë fshat, parcela 35/4,35/5,35/13, ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë“.

Mukades Gixhari . Andi Faleminderit. Miratim i projekt-vendimit, “Për disa ndryshime në VKB-në Nr.6, datë 27.01.2020 ‘Për Krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë



me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira) “. Kjo ishte pika 7-të lexojmë dhe tjetrën se është i njëjti person, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin subvencionimi i interesave të kredisë”. Atëherë keto 2 pika do t’i relatonte specialisti i administrimit vendor dhe strehimit z. Harun Murrani, për një angazhim të tijin ai nuk mundi që të vinte dhe mendoj që këto dy pika t’i shtyjmë për mbledhjen e radhës. Jeni dakord? Dhe kalojmë në pikën 9-të Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”. Koordinatorja e dhunës në familje znj. Dorina Maçolli. Përshëndetje Dorina!

Dorina Maçolli . Përshëndetje! Në radhë ta parë ju falenderoj për vëmendjen e dhunës me bazë gjinore. Masat e marra nga Bashkia Rrogozhinë për të parandaluar dhunën me bazë gjinore janë : Takimet ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese gra e vajza gjithashtu takime ndërgjegjësuese me burra dhe djem të mitur dhe fëmijë. Mbështetje psikologjike dhe ligjore falas për gra dhe vajza të dhunuara, mbështetje ekonomike nga fondi social i Bashkisë dhe në bashkëpunim me organizata joqeveritare. Takime me mekanizmin e referimit të rastit dhe me komitetin drejtues dhe ekipin teknik ndërdisiplinar që drejtohet nga unë dhe komiteti drejtues nga Kryetari i Bashkisë. Gjithashtu dërgimin e informacionit në mënyrë konfidenciale, reagimi nga forca e ligjit, urdhërat e mbrojtjes, dhe trajnimet e vazhdueshme për përmirësimin e mekanizmit të referimit. Unë do veçoja sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin pasi është pika kyçe ku gratë dhe vajzat marrin informacion. Nëse keni ndonjë pyetje?

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje për këtë që sapo prezantoi Dorina.

Emiliano Aliu . Ke një në Kamëz që është qendra e rehabilitimit... ke dhe një në Vlorë në rastin si veprohet se dhe kur është përcaktuar masa e urdhërit të mbrojtjes nuk është respektuar.

Dorina Maçolli . Në qoftë se kemi dhunë fizike, seksuale, në qoftë se kemi këto forma të dhunës jemi të detyruar që në qoftë se akoma nuk është dhënë vendimi i gjykatës dhunuesi është arratisur ose nuk është arritur të burgoset në bashkëpunim me organizatën me strehëzat dhe i nisim direkt në strehëz 72 orëshe ose varet më gjatë nga vendimi i gjykatës.

Emiliano Aliu . Zakonisht vendimi gjykatës sa kohë zgjat?

Dorina Maçolli . Brenda 72 orëshit.

Emiliano Aliu . Po kur është fundjavë?

Dorina Maçolli . Duhet të marrim autorizim nga Bashkia, ndjekim gjyqet dhe i jepët urdhër i menjëhershëm.



Emiliano Aliu . Duhet marrë parasysh rastet në fundjavë se rastet më të mëdha ndodhin kur dy partnerët janë në shtëpi dhe zakonisht ndodh ose në orët e vona ose ...

Dorina Maçolli . Ose ditët e festave, fundjavë. Pika kyç që kemi ne është se kemi një mekanizëm të mirëformuar, bashkëpunimin e kemi shumë të mirë. Përveç strehëzave me OJF-të kemi futur projekte kemi 4 për momentin që u vijnë në ndihmë grave dhe vajzave. Edhe takime me gra nëpër fasoneri, aty ku ka më shumë gra ose nëpër lagje.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Ndonjë pyetje tjetër? Znj. Alime.

Alime Hoxha . Mbështetje ligjore, ku konsiston?

Dorina Maçolli . Atëherë ne kemi një projekt që vjen nga nisma ligjore falas dhe ofrojmë avokat falas për gra që nuk kanë mundësi të paguajnë një avokat.

Mukades Gixhari . Faleminderit për informacionin dhe për punën e mirë që bëni. Kalojmë në pikën 10, Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i listës së aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2023. Specialisti i kulturës z. Endrin Ajdini. Përshëndetje z. Endrin, fjala për ju!

Endrin Ajdini . Si jeni, ju përshëndes? Disa shërbime janë funksionale për ne është biblioteka, kemi abonentë që regjistrohen përditë. Studio e inçizimit, kurset e fëmijëve tani kemi vetëm kursin e pianos për momentin. Kurse përsa i përket tek pjesa turizmit dhe tek nxënësit e shkollave me 6 Prill do na vijnë gjithë librezat që kanë për Kalanë e Bashtovës. Pastaj disa aktivitete vazhdojnë pas datës 6 Prill kemi ditën e romëve tek pallati i kulturës edhe në vazhdim pastaj kemi tek turizmi Panaire, hapjen e sezonit turistik të Bashkisë festat zyrtare normalisht janë pjesë e jona. Bashkëpunimin me shkollat normalisht e kemi për momentin s’kemi muzeun e qytetit dhe murin e propagandës.

Emiliano Aliu . Është marrë ndonjë masë në transmetimin e videove dokumentare të ndryshëm historike sepse deri tani kemi? Flas të paktën dokumentare historike të cilët kanë të bëjnë shumë e zëmë kur bëhet gjatë një seance një mësimi, lufta e dytë botërore ose genocidi ndaj hebrenjve, pakicave të tjera do ishte mirë një iniciativë videotransmetuese. Sepse duhen marrë këto masa nuk duhet të jetë vetëm thjeshtë recital, muzikë, ekspozitë. Kështu që të paktën duhet parë mundësia e transmetimit por flas për një gjë që i duhet dhënë fëmijëve mos të rrinë duke kërkuar informacion, zysh Alime e di që ti ke dhënë të paktën disa kërkime detyra që fëmijët të sjellin projekte nëpërmjet dhe ai shkon në “youtube” ku ka më mirë se të mblidhesh dhe të organizosh



me drejtorat me mësuesit që të marrësh çështje që ti afrohen pak më shumë qendrës. Them dokumentare historike që i gjen goxha në arkiva dhe mund të bësh kërkesën direkt në mënyrë zyrtare tek arkivat qendrore të Republikës së Shqipërisë sa të duash në luftëra me partizanë etj, pavarësisht janë të dubluar por gjithsesi nuk mund ta fshijmë historikun. Unë kam parë dy dokumentarë të fundit dhe kam nisur nga vetja ime që kam mësuar gjëra që nuk i dija. Arkivat italiane ti i di shumë mirë që mund të bësh dhe një partneritet në Itali në këtë drejtim që të sjellin dokumentarë me thënë të drejtën këto nuk i shohin vetëm nxënësit. Varet nga publiciteti që ti i bën varet dhe nga PR (piar) që ti i bën, psh unë nuk kam ndonjë ftesë që Qendra Kulturore Haxhi Memolla ka hapur një facebook apo instagram që të di aktivitetet. Kështu që unë nuk di kalendarin, absolutisht unë e kam idenë përveç se kur i publikon kryetari vetë, ndonjë nga anëtarët e këshillit bashkiak apo në facebook-un e shkollave, vetë facebook-u i qendrës nuk ka. Unë ta këshilloj Mario mund të të ndihmojë të asistojë aty ke konfirmime e gjëra. Pse? Ti po bën punë por nuk duket po flas në përgjithësi kështu që përveç muzikës dhe të përgëzoj për pianon për kitarën çdolloj iniciative artistike unë e kam thënë që në fillim ky qytet jo vetëm këtu por në të gjithë republikën e Shqipërisë të paktën në kohët e fundit që kam kaluar ka nevojë dhe arti po zhvlerësohet në maksimum në Shqipëri dhe po na ikin të gjithë artistët jashtë. Edhe Rrogozhina ka talente ti i di shumë mirë më mirë se unë por duhet të ketë dhe aktivitete të zbulimit të talentit, ti mund të organizosh aktivitete promovuese duke u lidhur me organizatat e tjera . Psh konkursi i pikturës, konkursi i poezisë, duhen bërë thashë ti po bën unë nuk di gjë se unë i ndjek unë facebook-un nuk dua ta përdor më por ama e përdor vetëm për punë dua të ndjek informacione e vetme që kam për ta marrë e marrim nëpërmjet rrjeteve sociale. Kështu që është këshilla unë thashë vitin e parë ke shumë punë duhet të ngrehesh duhet të lidhesh, ke arritur goxha dhe je mirë. Çështja është unë po të jap një shtysë tjetër ose një këshillë tjetër.

Endrin Ajdini . Kurse vetë kam qenë tek të gjithë aktivitetet që janë bërë për pjesën për fëmijët kam qënë normalisht. Përsa i përket ëëbsite -it pastaj duhet parë...

Emiliano Aliu . Jo ëëbsite, po flasim për facebook që është shumë e thjeshtë të krijohet e menaxhon dhe vetë dhe nuk ke nevojë... 5 minutësh punë është. Thjeshtë punën që bëjmë ta bëjmë vizive ta bëjmë të dukshme.

Fatmira Thartori . Kisha një pyetje për Endrinin. Atëherë dëgjova që janë hapur kurse për piano. A keni bërë njoftime në komunitet?

Endrin Ajdini . Po.

Fatmira Thartori . Në cilat forma janë bërë njoftimet?



Endrin Ajdini . Për kurset?

Fatmira Thartori . Për kurset.

Endrin Ajdini . Janë bërë njoftime që janë hapur kurset.

Fatmira Thartori . Pyetja ime ishte konkrete. Cilat janë format që ju keni përdorur për të bërë njoftimet për kurset e pianos? E keni bërë vetëm për qytetin apo për të gjithë njësitë e tjera?

Endrin Ajdini . Për të gjithë është bërë për të ardhur në kurse por ideja është që do i mundësohet transporti.

Fatmira Thartori . Pyetja ime ishte konkrete dhe besoj se e kuptove pyetjen?

Endrin Ajdini , Po, e kuptova me afishim.

Fatmira Thartori . Cilat janë format që janë përdorur për të përhapur informacionin që janë hapur kurset e pianos? Mos ka vetëm fëmijë Rrogozhina?

Endrin Ajdini . Po, kryetari tek faqja e bashkisë.

Fatmira Thartori . Mos ka fëmijë vetëm në Rrogozhinë?

Endrin Ajdini . E ka hapur kryetari i bashkisë tek faqja, se unë nuk kam faqe.

Fatmira Thartori . Dhe kur përfundonkan kur fillojnë?

Endrin Ajdini . Kurset kanë filluar, kemi 18 fëmijë që vijnë.

Mukades Gixhari . Është çdo ditë?

Endrin Ajdini . Çdo ditë, për momentin është 3 herë në javë.

Alime Hoxha . Nga Njësitë është problemi i transportit?

Fatmira Thartori . Prap sido të jetë zysha ka mungesë informacioni për këtë pjesën.



Endrin Ajdini . Kurset janë falas që ta dini.

Fatmira Thartori . Dihet që kurset bëhen falas aty por që është mungesë informacioni.

Emiliano Aliu . Nuk ju kushton gjë një format A4 me e printuar dhe keni lidhje me shkollat e mesme 8-vjeçare.

Endrin Ajdini . Po por me çfarë do vijë?

Fatmira Thartori . Drini tek kjo pjesë mos mer pjesën tjetër të përgjegjësive . Përgjegjësia juaj është informimi.

Endrin Ajdini . Informimi është bërë tek faqja e Bashkisë.

Fatmira Thartori . Vetëm kaq?

Endrin Ajdini . Po, vetëm kaq.

Fatmira Thartori . Jo, duhet më tepër janë gjithsej 11 shkolla në ZVA-në Rrogozhinë duhet patjetër të përhapen nëpër shkolla. Ky është njoftimi më i mirë se fëmijët aty përqëndrohen në institucionet shkollore.

Endrin Ajdini . Të falenderoj.

Emiliano Aliu . Krijë një grup në email jo të ja dërgosh një javë përpara por të ja dërgosh në momentin e parë që ti do kesh një aktivitet jo vetëm për kurset për çdo gjë. Qendra Kulturore me datë kaq ka këtë aktivitet kaq, mjafton ti ja çon me email e marini e kanë ata në dorë. Se e printojnë se e afishojnë nëpër shkolla se njofton njerëzit individët nuk duhet parë vetëm kjo se ka disa mënyra informimi. Informimi në media është më i rëndësishmi kush ka informim ka shpatën ka dhe krahun ka dhe gjëra tjera kështu që janë disa prandaj thashë që facebook page është i pari sepse të gjithë jemi në rrjetet sociale. Për aktivitete publikime mund të krijosh instagramin dhe është shumë e thjeshtë dhe unë thashë nuk i dua por i kam detyrim nga puna, biles mua më kanë kërkuar dhe LinkedIn nuk po flas për Tëitër se ai është tjetër e kam dhe atë, që të arrihet çdo gjë ndarje informacioni tek njerëzit. Ndiq rrejtin shkollor emrat e drejtorive i çon emailin ta kam dërguar i thua, facebook page-in tënd duhet ta publikosh ti pas kësaj. Se e publikon tek faqja e Bashkisë se ja shpërndan kryetarit apo nga Këshilli ajo është pak rëndësi, ti duhet të bësh detyrën tënde dhe detyra jote janë këto tre rrugë.



Fatmira Thartori . Është bërë gjë e mirë kjo qendra kulturore por duhet patjetër që të informohemi, puna është që të vihet në dukje gjithë kjo pjesë që po bëhet.

Mukades Gixhari . Po z. Enver.

Enver Memolla . Në lidhje me këto që dolën se jo të gjithë mund ta ndjekin faqen e Bashkisë por ajo që unë sugjeroj është që të ketë një ndërmjetësim një bashkëpunim midis institucioneve. Drejtoria arsimore e Bashkisë mund t'i drejtohet ZVA-së me shkresë zyrtare sepse ne talentet në shkollë do i gjejmë nuk do i gjejmë diku tjetër të vihen në dijeni drejtoritë e shkollave orari programi që ka qendra kulturore të bëhet në rrugë zyrtare më mirë.

Emiliano Aliu . Janë këshilla.

Endrin Ajdini . Ju ma bëni punën më të thjeshtë, pa këshilla nuk ka kuptim.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Vazhdojmë me pikën 11, Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë. Drejtori i bujqësisë z. Andi Proshka.

Andi Proshka . Faleminderit. Për sistemin e kanaleve vaditëse dhe kulluese si dhe hapjen dhe pastrimin e kanaleve të dyta të treta për të gjithë territorin e Bashkisë sipas njësive përkatëse. Problematikat e këtyre kanaleve vaditëse dhe kullues janë të akumuluar ndër vite dhe jemi munduar ti japim zgjidhje problemeve që kërkojnë ndërhyrje emergjente. Përgjatë vitit 2023 problematikat janë në Njësinë Administrative Kryeviidh fshati Ballaj vendosja e një porte hekuri tek kanali i ujërave të para e cila... Situata e rezervuareve në mbështetje të vendimit për digat në zbatim të urdhërit 14.12.2022 të kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë është ngritur grupi i punës nga punonjësit e bashkisë për menaxhimin dhe kontrollim e këtyre hrezervuareve. Gjatë vitit 2023 duke mbajtur procesverbale për çdo problematikë që ne kemi pasur. Në territorin e Bashkisë Rrogozhinë janë gjithsej 10 rezervuare si ujëmbledhës të cilët janë të pajisur me patentë. Gjatë periudhës Nëntor 2022-2023 janë bërë konstatime dhe mbajtur procesverbale nga specilaistët përkatës bashkëngjitur keni dhe procescerbalet me grupet e punës të inspektuara nga Bashkia Rrogozhinë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje në lidhje me këtë që sapo na relatoi Andi? Po z. Petrit Haska.

Petrit Haska . Për bujqësinë raporti është kërkuar me 14 Nëntor 2022 ti vjen raporton sot për rezervuaret me 27 Mars. Po gjendja faktike sot si është, sot që flasim?



Andi Proshka . Për rezervuaret ne japim informacion dy herë në vit dhe në dimër dhe në fund të vitit. Janë ngritur grupet e punës ku ka rezervuare këto bëjnë kontrollet për rezervuaret mbajnë procesverbal për këtë ne mbledhim procesverbalet dhe i drejtohem i KPKD-së dy herë në vit bëhet kjo gjë.

Petrit Haska . Në gjithë rezervuaret gjendja është mbi mesataren?

Andi Proshka . Mesatarja nuk është rrezik sepse ka porta deri kur arrin niveli maksimal fillon e shkarkohet.

Petrit Haska . Nuk ka një rezervuar njëri më pak e njëri më shumë, si ke parë?

Andi Proshka . I kam parë, unë nuk i shikoj ato? Të gjithë janë në kuotën mbi mesatare vetëm rezervuari i Shardushkut është jashtë përdorimi.

Petrit Haska . Këtë e di, ne jse ti ke mendimin tënd unë kam një sugjerim nuk e keni në kontroll. Të bëhen para 4 muajsh procesverbalet, vjen i raporton sot.

Andi Proshka . Sepse kështu është rregulli ligji dy herë në vit bëhen këto kontrolle.

Petrit Haska . Po pse nuk u bë para 1 jave gjëndja reale?

Andi Proshka . Janë ngritur grupet e punës për çdo Njësi Administrative mbajnë procesverbale për çdo rezervuar ne i mbledhim dhe i drejtohem i KKDM-së.

Petrit Haska . Kanalet e para të dyta të treta, sa kilometra ke bërë? Ke bërë kanalet kulluese vaditëse tjerat para ...

Andi Proshka . Nuk i kam me shifra janë diku tek 26 km.

Petrit Haska . Si nuk i kam me shifra ti thua kam pastruar këtu, silli shifrat.

Andi Proshka . I kemi shifrat.

Petrit Haska . I ke në zyrë.

Andi Proshka . I kam dhënë çdo mbledhje nuk është se nuk i kam këtë herë.



Petrit Haska . Po ti njëherë në tre muaj njëherë në 4 muaj ke dhënë.

Andi Proshka . Mbledhjen e kaluar kanë qenë me detaje ju kam sjellë edhe planet.

Petrit Haska . Kanalet nuk janë kapur me dorë kanë 6 vjet, asnjë kanal nuk është kapur me dorë.

Andi Proshka . Nga kërkesa i është bërë ministrisë gjatë kësaj kohe na ka ardhur një skrep 23 tonësh nesër fillon punën.

Mukades Gixhari . Ta dëgjojmë pak z. Enver Memolla.

Fatmira Thartori . Më fal ka ardhur një skrep? Goxha mirë për Bashkinë tonë.

Andi Proshka . Po, kemi bërë disa kërkesa edhe nesër fillon punën.

Enver Memolla . Për ta nisur unë do ta nis tek kjo mbledhja që bëmë me Bashkitë e Forta me datë 21. Kjo është hedhur tek faqja e Këshillit Bashkiak një pyetësor online këtu janë angazhuar në mos gaboj 105 persona dhe një nga pikat ku banorët të pa ndikuar nga askush kanë shprehur lirshëm menaxhimin e infrastrukturës së ujit dhe kullimit dhe kjo shkresë i ka shkuar dhe Bashkisë Rrogozhinë. Ajo çfarë unë shoh dhe tek pjesa e pikës së rendit të ditës pata kërkuar dhe shtimin e sipërfaqes së dëmtuar nga lumi Shkumbin nga erozioni. Drejtoria ma ktheu përgjigjen që duke parë dhe ankesën nga aplikantët që janë për pjesën e subvencioneve të bujqësisë që është gjë e mirë do pres për radhën tjetër. Ajo çfarë doja të shtoja është që më në fund në Rrogozhinë ka ardhur ai skrepi i madh që pritej nuk e di a është në punë tani. Realisht po flas për pjesën e Rrogozhinës me Andin diskutoj shpesh e dimë ku janë pikat e kuqe për këtë sezon ajo çfarë unë doja të ndihmonte shumë drejtoria e bujqësisë është bashkëpunimi me bordin për pjesën e kanaleve të ujërave të larta se e di që ju e keni problem atë pjesë dhe shumë herë ju ka frenuar e kam thënë dhe mbledhjen e kaluar ju ka frenuar në bërjen e investimeve, sepse investimi juaj pa ato del nuk kryen funksion. E kam thënë dhe tek kjo mbledhja që kemi bërë e kam shprehur që realisht duhet një bashkëpunim dhe gjëja tjetër është e thashë dhe herën e parë nuk e di nëse ke info për kanalën Peqin Kavajë a ka problematikë, apo kur pritet të lëshohet. Duke marrë shkas dhe nga vonesa e vitit të kaluar.

Andi Proshka . Problematika dëme të mëdha nuk ka, akoma nuk është vendosur një datë kur do fillojë vaditja.

Enver Memolla . Një pyetje rreth praktikës, të gjithë portat vaditëse janë në gatishmëri për këtë vit?



Andi Proshka . Janë 2-3 porta që kemi në plan t'i riparojmë.

Enver Memolla . Në Rrogozhinë?

Andi Proshka . Në Gosë.

Enver Memolla . Unë kaq kisha por pjesa që cedon më shumë këtu është pjesa e kanaleve të ujërave të larta.

Andi Proshka . Edhe porta në Ballaj ka 2-3 vite që nuk ka vaditur pjesa matanë por do bëjmë të mundur...

Enver Memolla . Unë konkretisht flas për kanalin e zogut, ti e di shumë mirë quhet vija e zogut nga Sinaballaj buron në grykëderdhjen e Shkumbinit që ajo është tashmë përballja e presionit për tokat e Rrogozhinës. Besoj ti je i qartë ta kam thënë nuk e di çfarë masash do merrni se realisht është vatër infeksioni. Nëse nuk pastrohet këtë vit vazhdon vaditja në këtë gjendje infektimi i tokave do jetë i pashmangshëm. Kaq kisha.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Enver, ndonjë diskutim tjetër? Faleminderit Andi. Kalojmë tek pika 12 Të ndryshme, Shqyrtim të thirrjes së kontabilistit të shoqërisë “Klub Futboll Egnatia” Sha, drejtuar aksionerëve të kësaj shoqërie. Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse z. Olsi Dranga. Përshëndetje Olsi.

Olsi Dranga . Përshëndetje të gjithëve! Tani edhe unë jam vënë në dijeni të raportit por normalisht duhet të ishte dhe vetë kontabilisti i firmës, gjithsesi ky është një dokument fillestar që është paraqitur në Këshill Bashkiak më pas në veprimet financiare që ka kryer shoqëria të ndarjes së përqindjeve dhe kërkon ndër të tjera kërkesa është për një raport më të detajuar më saktë që bëhet nga një auditues i jashtëm në këtë rast. Nuk kryhet më as nga kontabilisti i shoqërisë dhe as nga drejtorja e financës së Bashkisë. Këtu kërkohet vetëm në kërkesë besoj se është e qartë se po e shikoja pak edhe më me detaje. Për këtë duhet që më përpara të bëhen përlllogaritjet nga ekspertë të fushës përkatëse, që do të thotë raporti që sjell kontabilisti i shoqërisë duhet analizuar nga auditues të jashtëm për saktësimin e raportimit që ai ka bërë. Dmth duhet thjeshtë një miratim për audituesit për të nxitur këtë, besoj ky është hapi i parë për veprimtarinë e shoqërisë sepse siç e dini jeni aksionerë në shoqëri dhe normalisht ata tani kanë sjellë kërkesën dhe raportin, at në këtë rast kontabilisti i shoqërisë, bazuar dhe në transfertat që ka bërë drejtori i financës dhe thjeshtë kërkojnë një raport më të detajuar për të parë përqindjet. Unë po ju bëj një prezantim të shkurtër për sa jam në dijeni të dokumentit.



Rezart Vogli . Kërkesa është që i kërkohet Këshillit Bashkiak të autorizojë një auditues të jashtëm ...

Olsi Dranga . Për vlerësimin e të gjithë raportit financiar, kjo është si një hap i parë.

Enver Memolla . Fakti është mirë apo keq vjen po ti përballë nesh si relatori i privatizimit të Klub Futboll Egnatia po ta nis nga këtu. Dhe kjo që kërkohet ta kam thënë që do vijë dita dhe dita erdhi nuk e di pse nuk ka ardhur vetë kontabilisti por realisht këtu kërkohet vlerësimi i kuotave të fushës. Po ta shikosh ta ka shprehur qartë : për këtë duhet që më parë të bëhen përlllogaritje nga ekspertë të fushëspërkatëse si dhe nga ekspertë të financës në mënyrë që vlera e fushës të shtohet si kontribut në natyrë nga ana e ortakut Bashkia Rrogozhinë tek shoqëria.

Olsi Dranga . Jo, ja po ta lexoj saktësisht: për këtë kërkohet që nga ortakët kontributi të jetë ose në para pas raportit të audituesit...

Enver Memolla . Kalo poshtë këtë që të citova që të lexova unë.

Olsi Dranga . Jo po kaloj më lart jo më poshtë .

Enver Memolla . E ke që për këtë duhet që më parë të bëhen përlllogaritje nga ekspertë të fushëspërkatëse si dhe nga ekspertë të financës në mënyrë që vlera e fushës të shtohet si kontribut në natyrë nga ana e ortakut Bashkia Rrogozhinë tek shoqëria nga njëra anë.

Olsi Dranga . Jo unë jam pak më lart po them.

Enver Memolla . Atëherë kjo shkresë i drejtohet këshillit bashkiak sepse ai është pronar i aseteve të bashkisë Rrogozhinë është e pasaktë formati që ka ardhur ...

Olsi Dranga . Dakord në qoftë se duhen dokumenta shtesë mund të plotësohen.

Enver Memolla . Çfarë duhet e dinë juristët e Bashkisë dhe e di Bashkia që ta sjelli si duhet se kjo është thjeshtë një thirrje që i bëhet këshillit bashkiak dhe kjo vë në lëvizje ujërat.

Olsi Dranga . Shiko që një raport financiar nga një auditues i jashtëm duhet bërë çdo vit kjo është e pa ...

Enver Memolla . Duhet bërë ... nuk po i hyj asaj fare unë po i hyj vetëm shkresës.



Olsi Dranga . Këshilli miraton merr nismën e nxit për audituesin e jashtëm në këtë rast, jo se merr ndonjë vendim thjeshtë audituesi i jashtëm aprovohet Bashkia që të nisi procedurën për audituesin e jashtëm dhe për të parë saktësinë e dokumentacionit.

Enver Memolla . Këtu duhet të jetë kryetari i bashkisë dhe Këshilli Bashkiak se Bashkia është pronare e stadiumit dhe që ka vlerë fusha dhe kjo kërkohet përcaktimi nga njerëz të jashtëm nga financiarë të jashtëm se sa është vlera e fushës dhe përpara se të nisi nisma duhet të bie dakord bashkia me këshillin njëherë. Se këshilli e ka pronën ai është pronar i bashkisë...

Olsi Dranga . Unë e diskutova pak por meqë jam në dijëni të shkresës por do duhet dhe drejtori juridik .

Enver Memolla . Kjo është shkresë për të vënë në dijëni çfarë do ndodhë, në konceptin që unë e lexoj kjo është thirrje për të vënë në dijëni çfarë duhet të ndodhë në të mirë të mbarëvajtjes së ekipit. Apo jo? - Kjo është. Nuk e di nëse i ka ardhur drejtorisë...

Olsi Dranga . Po po drejtorja e financës është në dijëni, drejtorja juridike, drejtorja urbane dhe shërbimet mbështetëse.

Enver Memolla . Po e sportit?

Olsi Dranga . Arsim kulturës dhe sportit nuk e ka shtuar, nuk është cikluar për atë.

Enver Memolla . Po pra prandaj thashë kjo është pikënisja e punës dhe që të vazhdojë kjo nismë duhet leja e Këshillit Bashkiak, prandaj thashë kjo është thjeshtë vënie në dijëni. S'ka nevojë për miratim kjo është vënie në dijëni. Prandaj sot duhet të ishte këtu vetë personi në fjalë, që ta citonte dhe vetë ai se çfarë kërkon saktë sepse këtu mund ta konceptoj si dua unë, kjo është thjeshtë vënie në dijëni unë kështu e cilësoj. Këshilli Bashkiak jua dërgon pu juve.

Olsi Dranga . Kjo merret në shqyrtim sepse pastaj për të marrë vendim do jetë projektvendim ai nuk do jetë më ...

Enver Memolla . Ka gjëra tjera këtu por dole aty ku ta kam thënë para 1 viti .

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e dytë tek të ndryshme, Shqyrtim të kërkesës për ndihmë të menjëhershme ekonomike për një familje banuese në fshatin Zhabjak, propozuar nga Administratori i Njësisë Administrative Kryevidh z. Shkelqim Gjoni. Besoj e keni përpara materialin. Drejtori i Financës z. Rezart Vogli.



Rezart Vogli . Kemi një kërkesë nga administratori i Njesisë Kryevidh për një familjar Lulzim Xhiani i cili ka kaluar një fatkeqësi pasi i ka vdekur bashkëshortja nga martesë e dytë bashkëshortja ka sjellë një fëmijë me aftësi të kufizuara.

Enver Memolla . Ja vlen kemi dhe Lulin këtu.

Lulzim Hasa . Është një familje që i ka ndodhur fatkeqësi pas disa vitesh ka një martesë të dytë dhe fëmija ka probleme shëndetësore. Tani nga ana jonë është në rregull, sa është mundësia e mira është që ta stimulojmë.

Fatmira Thartori . Çfarë moshe ka zotëria?

Lulzim Hasa . 62 vjeç në mos gabohem.

Fatmira Thartori . Po anëtarë të tjerë të familjes janë të punësuar?

Lulzim Hasa . E thashë djali i ka vdekur e shoqja ka ardhur me probleme shëndetësore bashkë me fëmijën me të meta fizike nga martesë e dytë, s'është në punë as e shoqja as fëmija.

Enver Memolla . Këto trajtohen me KEMP?

Rezart Vogli . Po djali trajtohet me KEMP.

Enver Memolla . Nga Bashkia apo nga sigurimet shoqërore?

Lulzim Hasa . Si nga Bashkia si nga sigurimet shoqërore nuk përballon, do thuash ti çfarë do bëjmë ne ?

Fatmira Thartori . Ne nuk jemi kundra kësaj pjese përkundrazi jemi për ndihmë si nga ana materiale ekonomike financiare . Puna është që në qoftë se anëtarët e asaj familjeje do ishin në gjendje të punonin njëri nga ato të punësohej të paktën kjo është ideja ime.

Lulzim Hasa . Është një variant ...

Enver Memolla . Duke dëgjuar Lulin anëtarin kolegun pasi ai e njeh zonën. Pyetja që unë i bëj drejtorit të financës a ka buxhet bashkia ta kryejë këtë dhe sa mund të jetë fondi që mund të shkojë?



Rezart Vogli . Mund të jepet ndihmë e menjëhershme, në radhë të parë është e rëndësishme ajo që sapo citoi Luli sepse gjëndja ekonomike e sociale e familjes është e dobët. Nisur nga vendimi që do merrni sot përgatis projektvendimin për mbledhjen e ardhshme.

Lulzim Hasa . Do kalojë me projektvendim ajo nuk do kalojë kështu.

Emiliano Aliu . Të lutem Rezi brenda mundësive buxhetore, brenda kuadrit ligjor të shikohet mundësia dhe të na përcillet këtu mbledhjen e radhës sa mund të ndihmohet dhe si mund ta ndihmojmë këtë familje. Në rregull jemi?

Lulzim Hasa . Po.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Kalojmë në pikën tjetër, Shqyrtim i kërkesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për prerjen e disa pishave përgjatë kësaj lagjeje që mbartin pluhur dhe janë kthyer në problem për shëndetin e banorëve. Drejtori i bujqësisë z. Andi Proshka. Kemi një kërkesë nga banorët e lagjes.

Andi Proshka . E mira është që për këtë të njoftohet dhe firma që ka mirëmbajtjen e qytetit.

Enver Memolla . Duhet ftuar.

Emiliano Aliu . Urbanistika në këtë drejtim është më kryesorja sepse të heqësh pemë është e kollajtë . Ato me të vërtetë mbajnë pluhur por e dimë shumë mirë që ato mbledhin pluhur për të mos pluhurosur shtëpitë. Po thoja nëse pishat japin problem hajde t'i zëvendësojmë me të tjera .

Enver Memolla . Tani unë dua të kuptoj diçka. Kur filloi pjesa e rilindjes urbane në Rrogozhinë kur u prenë pemët e para pati shumë ngcmime e gjëra të tjera nga vetë komuniteti për prerjen e pemëve. Këto në të drejtën e tyre mund të kenë të drejtë por realisht edhe prerja e pemës me vendim ka kosto , duhet investim. Se faktikisht të gjithë po kërkojnë s'kemi ndriçim s'kemi gjelbërim dhe po e paguajmë. Tani së fundmi kanë filluar dhe lagje qyteti po bëhen me ndriçim një pjesë, i biem me këmbë hajde ta heqim. Ideja është nëse vërtetë këto nga një studim i drejtorisë së bujqësisë janë problem për shëndetin jo për pluhura por janë shqetësim për shëndetin e banorëve pastaj tek pjesa mban pluhur nuk mban pluhur mund të jetë e rrezikshme nëse kanë boçe që mund të bien kjo është pjesë tjetër. Kështu që unë ju sugjeroj si drejtori të merrni një vendim të caktuar dhe të drejtë.

Emiliano Aliu . Konsultojeni, shikojeni, inspektojeni pastaj vendosni ...



Enver Memolla . Merrni parasysh çdo gjë.

Emiliano Aliu . Ti ke dëgjuar për polenin që shumica e njerëzve janë alergjikë por prapë se prapë ato pemë nuk janë prerë. Dua të dal që për një individ nuk prehen, unë thashë siç e tha dhe Veri kur përbën nuk dua ta përsëris... unë jam kundër prerjes së pemës jam për zëvendësimin e tyre të gjendet mundësia për një pemë që të jetë sepse nuk po flas për procesin e fotosintezës nuk po flas për pastrimin e ajrit nuk po flas për uljen e temperaturave nuk po flas për gjëra të tjera se i bie të bëj biologjinë e klasës së 8-të nga fillimi. Po flas për një gjë që është në të mirë të popullit, biles të kemi mundësinë që të gjithë rrugën ta bëjmë me pemë. Pemët kur mbillen duan mirëmbajtje, jo si i mbjellin në Tiranë në orën 12 të drekës gjatë javës që i thajnë rrënjët se e dimë shumë mirë që duhet tek vesa e parë dhe natën kur bie dielli. Të lutem gjëja unë po e flas si qytetar i Rrogozhinës dhe si qytetar që jeton në Tiranë gjëja e parë që unë e kam parë si qytetar e kam zgjedhur ku të jetoj në atë shtëpi që unë e kam blerë, e kam blerë vetëm prej pemëve që ka rreth e rrotull. Dmth kam investuar për shëndet dhe për pastrim ajri, në të gjithë botën këshillohet mbjellja unë erdha nga Gjermania nuk kam parë një fshat pa pemë, tani ne t'i heqim?! Të gjejmë mundësinë sepse nuk të kushton fare në qoftë se ata përbëjnë rrezik, jo ti heqim por duhet të navinte një propozim që përbëjnë rrezik duhet t'i heqim. Nëse unë do jem në këtë këshill më vjen një propozim thjesht për t'i prerë, unë do bëj një oponencë goxha të madhe sepse jam për gjelbërim.

Andi Proshka . Ne kemi bërë fushatën e mbjelljes së pemëve...

Emiliano Aliu . Gjithsesi unë po e them parantezë sepse e di unë jam kundër betonizimit dhe jam pro gjelbërimit. Duhet një bashkëpunim drejtorish dhe të lutem analizojeni inspektojeni dhe na hajdeni me një propozim konkret.

Mukades Gixhari . Faleminderit Andi. Kalojmë tek pika tjetër, Shqyrtim i ankesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për rregullimin e lagjes ku jetojnë shtrimin, kullimin, ndriçimin e saj. Këtë pikë tek ë ndryshme do ta shtyjmë për mbledhjen e radhës pasi drejtori i politikave urbane, kishte një angazhim të tijin personal.

Enver Memolla . Po specialistët?

Emiliano Aliu . Nuk bëhet sepse duhet a ka një plan, a ka një buxhet...?

Mukades Gixhari . Ai ka qenë i njoftuar .



Enver Memolla . S'më kuptove të ishte një person të merrte dijëni, kjo është vënie në dijëni.

Mukades Gixhari . Kemi një projektvendim që e kemi shtyrë herën e kaluar për këtë mbledhje “Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh“ pai mungonte dëgjesa publike. Konfirmimin e keni të gjithë përpara dëgjesën publike me komisionet të firmosura ku tek grupi i punës një anëtar nuk ka firmosur. Po z. Lulzim meqë je pjesë e komunitetit atje.

Lulzim Hasa . Këtu bëhet fjalë për një fshat Zeshtik quhet në hyrje të Zhabjakut para disa vitesh u ndërtua rruga me standarte bashkëkohore me trotuare me ndriçim. Në fshat ndodhen disa varre që askush nuk ja di identitetin mund të jenë mbi 100-vjeçarë. Të gjithë banorët janë të një mendimi që këto të hiqen dhe të varrosen tek varrezat ekzistuese të fshatit sepse ndodhen në qendër të fshatit. Aty është një projekt vendor për një lulishte.

Emiliano Aliu . Mos fol më se i kemi dëgjuar, thjeshtë kërkuam një dokument i cili erdhi është ngritur grupi i komisionit nga 6 persona, janë marrë firma nga 7-anëtarë dhe grupi i komisionit në fund fare është firmosur nga pesë në mungesë të njërit. Kështu që përderisa dokumenti është me firma ... po , Veri.

Enver Memolla . Unë një pyetje kam këto 7-persona që kanë firmosur janë banorë apo njerëz të afërt të atyre që kanë mbetur?

Lulzim Hasa . Askush unë e thashë që në fillim askush nuk ja di identitetin, thjeshtë shenjë varresh.

Mukades Gixhari . Ndonjë diskutim tjetër? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro projekt-vendimi me shkresë Nr.773.Prot datë 27.02.2023, “Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh“ dhe Relacioni me Nr.773/1.Prot datë 27.02.2023.

Vendim nr .12. Miratohet me 11 vota pro projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.773.Prot datë 27.02.2023, “Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të fshatit Zeshtik Njësia Administrative Kryevidh“ dhe Relacionin me Nr.773/1.Prot datë 27.02.2023.

Mukades Gixhari . Kemi dhe një kërkesë tjetër. Komiteti i veteranëve të LANÇ-it, pasardhësve



nderi i kombit Bashkia Rrogozhinë. Do na e relatojë specialisti i kulturës z. Endrin Ajdini.

Emiliano Aliu . Ka disa gjëra teknike që...

Fatmira Thartori . Edhe unë kisha disa gjëra teknike se ne e lexuam por që kishte.

Endrin Ajdini . Një përcaktim i vendit ku do vendoset pllakada me emrat e dëshmorëve...

Emiliano Aliu . Nuk është pllakadë është...

Endrin Ajdini . Është obelisk.

Emiliano Aliu . Sepse pllakada është gjë tjetër dhe obelisku me përmasat 440 cm është gjë tjetër.

Endrin Ajdini . Përmasat janë sjellë, kjo sot ka ardhur.

Emiliano Aliu . E dua dhe feed back-un tuaj kolegë, biles më shumë të mësuesve sepse ka të bëjë dhe me historinë dhe mbas 90-91 jemi demokratë kështu që duhet parë dhe kjo unë nuk kam qenë kundër askujt. Unë në fakt nuk jam kundër iniciativës duhen përkujtuar këta njerëz, e para punës duhet urbanistika, duhet gjelbërimi edhe do isha pro sepse ato sponsorin e paskan gjetur nuk do të thotë gjete sponsor të investosh o burra të japim leje. Por do isha pro siç e the dhe vetë për kalanë e Bashtovës do mblidhet nga fëmijët një si tip broshure e vizatuar, jam në rregull. Por një gjë e tillë mund të bëhet dhe me lançimin e idesë se si mund të bëhet se normalisht ne kemi vendosur një pllakadë memoriale në qendër të Tiranës por nuk kemi vendosur obelisk por vetëm një pllakadë.

Endrin Ajdini . Kjo sot është vetëm për ta hedhur në shqyrtim, të marim një miratim në parim nga Këshilli.

Enver Memolla . Kjo është vënie në dijeni këshilli bashkiak, këshilli jua drejton po ju si bashki.

Emiliano Aliu . E ke lexuar poshtë, për dijeni kryetari i bashkisë për zbatim Këshilli Bashkiak, sipër në krah të djathtë që në këtë drejtim është e gabuar.

Endrin Ajdini . Në një vend në Rrogozhinë kanë mernduar tek parku Sinaballaj, Kryevidh, Luz i Madh, Lekaj, Vilë Bashtovë dhe Gërmenj.



Emiliano Aliu . I njëjti obelisk do jetë sipas propozimit të tyre?

Endrin Ajdini . Jo, duhet të jetë po Sinaballaj ka të vetët.

Emiliano Aliu . Në qoftë se ti e ke kështu pa këto dy fletët unë do thoja ku është hapi jonë i radhës?

Enver Memolla . Atëherë nga takimi që unë kam pasur vetë me Sabri Mingën para një ore e ca, obelisku është vetëm për në Rrogozhinë kurse për njësitë është pllakada me emra. Kështu thotë pllakadë me emra.

Endrin Ajdini . Këtë po thoja, njësia Sinaballaj ka 9-të, obelisku është e përgjithshmja.

Enver Memolla . Realisht shkresa është drejtuar pak gabim poshtë ku thotë kërkoj aprovimin e këshillit bashkiak. Duhet ta miratoni ju projektvendimin e ta sillni në këshill bashkiak.

Emiliano Aliu . E di ku do dal Endri ne kemi shumë artistë mua më pëlqen arti, që në shumë mirë mund të vendosim diçka të bukur atje dhe me një pllakadë që del bukur dhe për qytetin e dukshme artistike nuk jemi që të kalojmë unë po flas si qytetar jo si këshilltar apo nënkryetar këshilli ta shoh këtë lapidarin nuk e quaj obelisk, unë e quaj lapidar të Enverit këtë kërkoj ndjesë. Edhe unë dua ta mbroj se unë kam qenë më i miri në kohën e Enverit i mbrojtur nga të gjithë gjërat, se sa në kohën e demokracisë por ama në mes të qytetit i ka dalë koha. Kemi artistë sa të duash mund të ndërtohet një vepër arti shumë e bukur dhe në një pllakadë pse mos ta hedhi bashkia kur ta marrë nga urbanistika e hedh në bursë siç e bën dhe bashkia e Tiranës e miraton vetë qyteti çfarë duan të shikojnë atje jo ne qytetarët vetë vendosin, u krye. Mbaroi përderisa ka sponsorin akoma më mirë, biles dhe po nuk arriti shumë që është diçka një vlerë e shtuar qytetit mund të arrijmë deri në konkluzione dhe mundësinë që vetë Bashkia në mundësinë e saj mund të shtojë një pjesë. Unë të jap tani merre si këshillë, kolegë është mendimi im si qytetar jo si anëtar.

Petrit Haska . Sheh atje në Tiranë dhe na thua ne këtu.

Fatmira Thartori . Po ne ashtu duam ta bëjmë Rrogozhinën.

Emiliano Aliu . Më vjen keq Petrit unë Rrogozhinën e dua jo si Tirana por si Bazeli si Zyrihu unë e dua si Berlioni. E bëjmë të paktën jo ne por fëmijët e fëmijëve tanë do kenë...

Mukades Gixhari . Z. Enver.



Enver Memolla . Tani tek të ndryshmet unë pata kërkuar informacion për pjesën e ujësjetës kanalizime Rrogozhinë dhe Visi më ka vënë në dijeni që përgjegjësja ka pasur një problem shëndetësor. Atëherë dua ta rikujtoj Vis nuk të thashë të ja kërkojsh Rrogozhinës duhet të ja kërkojsh drejtorisë rajonale të UK Durrës, se atje varemi sepse edhe po të vijë këto të Rrogozhinës atje do na thonë të drejtohem. Duhet të vijë ato dhe një përgjegjës çfarë ka firma që merret me punimet. Dhe gjëja tjetër që do shtoja marr shkas dhe nga pjesa Ledi iku, për pjesën e atyre personave që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe që janë të aftë për punë të lutem një kërkesë me shkrim që të vijë të raportojë përgjegjësi i zyrës së punës e kemi këtu tani, që sa kërkesa për punë ka aktualisht në zyrën e punës të Bashkisë Rrogozhinë. Ta dimë ku t'i delegojmë se mund të ketë njerëz që kanë ndonjë zanat dhe mund të ketë biznese që sot janë duke vuajtur krahun e punës kështu që ti drejtojmë atje dhe mos t'i lejmë tek 12 mijë lekëshi. Unë kaq kisha.

Alime Hoxha . Kam vënë re ka dy ditë që koshat e Rrogozhinës nuk janë pastruar.

Mukades Gixhari . Është për të gjithë kjo për të gjithë njësitë.

Petrit Haska . Alime më fal sa kanë 2 ditë? 1 muaj ka tek ne.

Alime Hoxha . 2 ditë ka aty dhe janë mbushur përveç koshave edhe pjesa tjetër sepse ka dhe një problem tjetër aty është përballë supermarketit dhe të gjitha mbeturinat e supermarketit hidhen tek koshat dhe ato mbushen para.

Lulzim Hasa . Ne kemi vende alternative ku i hedhim.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi diskutime të tjera mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit të gjithëve.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 20^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 1 orë : 13 min ; 13 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen (njëzet e shtatë).

Miratohet procesverbali :

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**